

**DEKLARATAT FINANCIARE DHE RAPORTI I AUDITORIT TE
PAVARUR**

**Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar Komune Rahovec
15 Tetor 2010 – 21 Nëntor 2010**

Raundi i dytë i zgjedhjeve 13 Dhjetor 2010 – 19 Dhjetor 2010

Prishtinë, Dhjetor 2012

Përmbajtja

Hyrje.....	3
Shpjegimi i termeve dhe i shprehjeve.....	4
Programi i Auditimit.....	6
Rezultatet dhe vëzhgimet e përgjithshme.....	7
Gjetje e përgjithshme te këtij raporti.....	10
Rekomandimet.....	11
Raportet e Publikimeve Financiare dhe të gjeturat e Auditorit	12

I. HYRJE

Qëllimi i këtij Raporti të Auditimit të Publikimeve Financiare të Fushatës të Subjekteve Politike është që publikut t'i paraqiten informatat e transaksioneve financiare të periudhës së fushatës të atyre Subjekteve Politike të cilat kanë garuar në Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Rahovec për periudhën 15 Tetor 2010 – 21 Nëntor 2010 dhe Raundi i dytë i zgjedhjeve për periudhën 13 Dhjetor 2010 – 19 Dhjetor 2010

. Këto informata i paraqiten publikut për ta bërë procesin politik më transparent dhe Subjektet Politike më të përgjegjshme ndaj votuesve të tyre.

Publikimi Financiar i të hyrave dhe shpenzimeve të Fushatës është i obliguar me Ligjin 03/L-072 Për zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, Ligjin nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Rregulloret e KQZ-ës 01/2008, përkatësisht Rreg.12/2009 si dhe me Ligjin për financimin e Subjekteve Politike LIGJI Nr. 03/L-174;

Të gjitha Subjektet Politike që kanë garuar në zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Rahovecut, sipas Rregullës së Zgjedhjeve 12/2009, Kufizimi i shpenzimeve të fushatës dhe publikimi financiar, duhet të dorëzojnë raportet e përmbledhura për selinë qendrore dhe të degëve të tyre.

- Numri i subjekteve politike që kanë marrë pjesë zgjedhje e jashtëzakonshme për kryetar komune në Rahovec është pesë (5).

Çdo Subjekt Politik ishte i detyruar t'i përmbahet kufizimit të shpenzimeve prej 500€ për një mijë (1000) votues të regjistruar, ashtu siç ishte caktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Megjithatë vënia në zbatim e kufizimit të shpenzimeve është pjesë e rëndësishme e procesit të publikimit financiar, synim kryesor i publikimit financiar është që nga Subjektet Politike të kërkohet publikimi i burimeve të të Hyrave dhe shpenzimit të tyre.

KQZ-ja përcakton maksimumin e shpenzimeve të fushatës mbështetur në numrin e përgjithshëm të votuesve të regjistruar në listën e votuesve në kohën e adaptimit të fundit të listës së votuesve në dispozicion të KQZ-së

Shpenzimet maksimale për fushatë zbatohen për çdo mall dhe shërbim të shpenzuar për qëllime të fushatës pa marrë parasysh kohën e blerjes apo të pajisjes me shërbime.

Raporti i Publikimeve Financiare të Fushatës përmban:

Bilancin e gjendjes, i cili tregon pasurinë, detyrimet dhe kapitalin e partisë, duke përfshirë të gjitha degët e saj në ditët e para dhe të fundit të periudhës së përfshirë në raport.

Pasqyrën e fitimit dhe të humbjeve, e cila tregon të hyrat dhe shpenzimet e partisë, duke përfshirë të gjitha degët e saj gjatë periudhës së përfshirë në raport, dhe

Pasqyrën e cila tregon çdo pagesë që i është bërë personit tjetër gjatë periudhës së përfshirë në raport, nëse vlera e përgjithshme e të gjitha pagesave që i janë bërë atij personi gjatë kësaj periudhe tejkalon pesë mijë (5.000) Euro, duke shënuar edhe qëllimin e pagesës.

Çdo raport financiar vjetor duhet të përmbajë kopjet e dokumentacionit vijues:

- Pasqyrën financiare të subjektit politik të regjistruar për periudhën e përfshirë në raport;

-
- Faturat për të gjitha shpenzimet që tejkalojnë shumën prej njëqind (100) Eurosh;
 - Bilancet bankare për çdo llogari bankare të subjektit politik të regjistruar ose llogarive në emër të saj, dhe
 - Regjistrin e të gjitha kontributeve për subjektin e regjistruar politike të dhëna nga një burim i vetëm, nëse vlera e përgjithshme e kontributeve nga ai burim ka tejkeluar shumën prej njëqind (100) Eurosh gjatë periudhës së përfshirë në raport, i cili tregon:

Vlerën e secilit kontribut të dhënë subjektit politik;

- datën kur është dhënë secili kontribut, dhe
 - emrin e plotë, adresën dhe numrin personal, të pasaportës ose të patentë shoferit të kontribuesit.
 - subjektet politike që pranojnë kontribute nga Ndërmarrjet Private, të cilat, përmes kontratave me Institucionet e shtetit, kryejnë shërbime, duhet të përgatisin një listë të veçantë të kontributeve të pranuar.
- KQZ-ja duhet ti publikoj të gjitha raportet vjetore financiare së bashku me deklaratën e auditimit të subjekteve politike në faqen zyrtare të saj.

NSH, "Audit & Conto" Sh.p.k. është caktuar si kompani kompetente për të bërë auditimin e jashtëm të Raporteve të Publikimeve Financiare të Fushatës Zgjedhore për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Rahovecit për periudhën 15 Tetor 2010 – 21 Nëntor 2010 dhe Raundi i dytë i zgjedhjeve, periudha 13 Dhjetor 2010 – 19 Dhjetor 2010.

II. SHPJEGIMI I TERMAVE DHE I SHPEHJEVE

Për qëllimet e këtij raporti sqarojmë shprehjet vijuese:

“Subjekt Politik” do të thotë Parti Politike, Koalicion i Partive Politike, Iniciativë Qytetare ose Kandidatë të Pavarur të certifikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për pjesëmarrje në Zgjedhjet për Kryetar të Komunës.

“Kontribut” do të thotë dhuratë, subvencion ose trashëgim i cilitdo lloji që i jepet Subjektit Politik qoftë me para të gatshme, qoftë në natyrë (në mall ose shërbime), që përfshin pagesën e borxheve të Subjektit dhe sigurimin jo në baza komerciale, të Subjektit. Shërbimet që i sigurohen Subjektit Politik nga individë në mënyrë vullnetare jashtë orarit të tyre të punës dhe pa pagesë nuk konsiderohen kontribute. Kontributi realizohet atëherë kur Subjekti Politik përfiton nga kontributi.

“Kontribut në natyrë (në mall ose shërbime)” do të thotë mallra ose shërbime që i sigurohen Subjektit Politik pa kurrfarë pagese si përgjigje ndaj tyre.

“Kontribute të tërthorta” do të thotë kontribute të bëra përmes një individi nga paratë, prona, ose shërbimet e një pale të tretë .

“Shpenzim” “shpenzim për fushatë”, do të thotë pagesa e bërë për mallra ose për blerjen e mallrave, materialeve, punës ose shërbimeve, qofshin ato lëndore apo jolëndore. Shpenzimi bëhet në datën kur bëhet pagesa ose blerja apo në datën kur sigurohen mallrat, materialet, puna ose shërbimet, pra cilado që bëhen më parë. që përcaktohen në nenin 3 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe me Ligjin 03/L-072 Për zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës.

“**Pagesë**” do të thotë pagesa e bërë gjatë periudhës së raportimit.

“**Donacion**” do të thotë kontribut në të holla ndaj një Subjekti Politik.

“**Kufizim i shpenzimeve të fushatës**” nënkupton shumën maksimale të parave që mund të shpenzohen nga një subjekt politik i certifikuar si shpenzime të fushatës për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës.

“**Auditor për Fushatë**” nënkuptohet organizata e cila është e ngarkuar nga Zyra me detyrë specifike të auditore shpenzimet e fushatës siç është përshkruar në nenin 41.1 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Ligjin 03/L-072 Për zgjedhjet Lokale ne Republikën e Kosovës.

“**Llogari të pagueshme**” do të thotë Shpenzim i realizuar por që nuk është paguar gjatë periudhës së raportimit, prandaj ai është detyrim që Subjekti Politik është i obliguar të paguajë ndaj personit tjetër.

“**Mjete**” do të thotë e tëra pasuria e paluajtshme apo personale e poseduar drejtpërdrejt apo tërthorazi, duke përfshirë para të gatshme në dorë apo depozitat bankare, si dhe të ardhurat që burojnë prej tyre nga shitja, posedimi apo marrëveshje tjetër, vlera e bizneseve në pronësi dhe çdo send në zotërim që ka vlerë më të madhe se pesëqind Euro (€ 500), me jetëgjatësi ekonomike më të gjatë se tri (3) vjet.

“**Detyrim**” do të thotë të gjitha shumat në para të cilat Subjekti Politik është i detyruar t’ua paguaj personave të tjerë ;

“**Saldo**” do të thotë ndryshmi ndërmjet mjeteve dhe detyrimit siç është definuar më lart;

“**Bilanc**” do të thotë Publikimi Financiar i Mjeteve, Detyrimeve dhe Saldos të subjekteve politike siç është definuar më lart .

Me Zyrë nënkuptohet Zyra e Regjistrimit të Partive Politike

SKK – Standardet Kosovare te Kontabilitetit

AK Autoriteti Kontraktues

ZKK Zgjedhjet për Kryetar Komune

KQZ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

SKQZ Sekretariati i KQZ-së

ZRPP Zyra për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim/Zyra

SP Subjekte Politike

SNA Standardet Ndërkombëtare të Auditimit

DF Deklaratat Financiare

LSHF Limiti i shpenzimeve për fushatë

ATK Administrata Tatimore e Kosovës

OJQ Organizata Joqeveritare

Fletë bilanci - deklarimi financiar i pasurisë, të ardhurave dhe detyrimeve të subjekteve politike;

Fondi për mbështetjen e subjekteve politike-Fondi - fondi për financimin e subjekteve politike përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës i cili funksionon në kuadër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;

Kontributet - dhuratat (donacionet) ose ndihma e cilitdo lloj që i jepet subjektit politik, qoftë në para të gatshme apo në të mira tjera materiale;

Kuotë anëtarësie - shumë e caktuar e të hollave, që paguhet çdo muaj ose çdo vit për anëtarësinë në një organizatë;

Pasuri - tërësia e sendeve, e mjeteve materiale, parave dhe e vlerave tjera që ka një subjekt politik;

Përfaqësuesi financiar - personi përgjegjës për mbajtjen e shënimeve financiare të subjektit politik;

Subjekti politik - parti politike, koalicion, nismë qytetare ose kandidat i pavarur;

Subjekt i certifikuar politik - subjekti i certifikuar politike nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në përputhje me ligjin në fuqi dhe me rregullat e KQZ-së;

Shpenzimet për fushatë - të gjitha shpenzimet dhe pagesat e bëra për mallra dhe shërbime në pajtim me ligjin për zgjedhjet e përgjithshme;

Të ardhura - çdo shumë monetare që subjekti politik ka pranuar nga personat fizik dhe juridik, kuota e anëtarësisë dhe Buxheti i Republikës

“Zgjedhje lokale” do të thotë zgjedhjet e Kuvendeve të Komunave dhe Kryetarëve të Komunave;

Të gjithë termat e lartpërmendur janë marrë nga Ligji për financimin e Subjekteve Politike LIGJI Nr. 03/L-174; Ligji 03/L-072 Për zgjedhjet Lokale ne Republikën e Kosovës; Ligji nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës

III. Programi i Auditimit

Metodologjia

Programi i auditimit e ka përqendruar shqyrtimin e vet në të gjitha Subjektet Politike që kanë marr pjesë në Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Rahovecit e të cilat kanë qenë të obliguara të dorëzojnë deklaratat financiare në harmoni me nenin 21 të Rregullës së KQZ-së nr 01/08, Ligjin 03/L-072 Për zgjedhjet Lokale ne Republikën e Kosovës dhe Ligjin nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës

Për SP-e të cilat kanë marrë pjesë në këto zgjedhje janë analizuar të gjitha faturat mbi 100.00€ dhe burimet e të hyrave.

Është bërë krahasimi i të dhënave në evidencat e partive politike në pajtim me nenin 21 të Rregullës së KQZ-së nr 01/08.

Auditimi është kryer në harmoni me SNA-Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe termeve të referimit nga AK duke pasur parasysh rekomandimin që margjina e gabimeve të mos jetë më e madhe se 10 %, (sa u përket shumave të mëdha) kurse në shumën më të vogël se 10,000 € kjo margjinë e gabimeve nuk tolerohet.

Gjatë auditimit ne kemi marr për bazë, por nuk jemi kufizuar, ne Ligjin 03/L-072 Për zgjedhjet Lokale ne Republikën e Kosovës, Ligjin nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Rregulloret e KQZ 01/2008, rreg.12/2009 si dhe Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike Nr. 03/L-174 Ligji Nr. 03/L-196 për Parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit; rregulloren e UNMIK-ut 2004/2 Kundër shpërlarjes se parasë dhe pengimin e financimit te terrorizmit

Auditimi i Publikimeve Financiare te Fushatës do të përfshij bilancin e gjendjes që tregon pasurinë, detyrimet dhe kapitalin e partisë, duke përfshirë të gjitha degët e saj në ditët e para dhe të fundit të periudhës së përfshirë në raport. Pasqyrën e fitimit dhe të humbjeve e cila tregon të hyrat dhe shpenzimet e partisë, duke përfshirë të gjitha degët, Pasqyrën e deklarimit te donacioneve ne te holla, pasqyrën e deklarimit te donacioneve ne natyrë ne mall dhe shërbime, pasqyrën që tregon çdo pagesë që i është bërë personit tjetër gjatë periudhës së përfshirë në raport, nëse vlera e pagesave që i janë bërë atij personi gjatë kësaj periudhe tejkalon pesë mijë (5000) euro, duke shënuar edhe qëllimin e pagesës.

Takime të shpeshta me Përfaqësues Financiar të Subjekteve Politike janë mbajtur gjatë auditimit me qëllim të sqarimit të disa shënimeve ose për të marrë informata shtesë lidhur me te hyrat dhe shpenzimet e fushatës. Ne kemi dorëzuar raportet preliminare sipas nenit 22.4 të Rregullës së KQZ-së nr 01/08 per regjistrimin dhe veprimin e partive. Partia politike brenda pesë (5) ditëve të punës nga marrja e rezultateve ka pasur afat kohor për të dorëzuar raportin e korrigjuar dhe për të komentuar mbi gjetjet e auditorit.

Auditimi i raporteve të Publikimit Financiar të Subjekteve Politike është rregulluar me Ligjin Nr. 03/L-073 dhe 03/L-072 pjesa e fushatës, Ligjin nr. 03/L-174 si dhe rregulla e KQZ-ës 01/2008 dhe 12/2009

Kontrolli i publikimeve financiare të SP është rregulluar me Neni 19 te Ligjit për financimin e Subjekteve Politike Ligji Nr. 03/L-174, sipas këtij Ligji:

- KQZ-ja e bënë kontrollin e secilit raport financiar vjetor.
- KQZ-ja e kryen kontrollin në përputhje me standardet e kontabilitetit të zbatueshëm në Kosovë.

Për të verifikuar Raportet e Publikimit Financiar të Fushatës, auditorët së pari janë bazuar në raportet e dorëzuara nga secili Subjekt Politikë. Publikimet Financiare janë verifikuar nëse teknikisht janë plotësuar si duhet. Janë përdorur metoda të krahasimeve dhe analizave; janë marrë konfirmime nga palët e treta si MEF-Departamenti i Thesarit, Bankat Komerciale, Mediat publike si RTK dhe TV 21; Media te shkruar , konfirmime nga palët e treta si kompani private etj, për të kontrolluar nëse informatat e paraqitura nga secili Subjekt ishin të besueshme. Shënimet e mëparshme mbi Subjektet Politike janë shfrytëzuar për tu bërë krahasimet me shënimet e reja, gamat e çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të ngjashme janë mbledhur nga tregu, si dhe faturat, dëftesat dhe dokumentacioni tjetër përcjellës janë krahasuar duke iu referuar shifrave të publikuara. Informata nga stacionet kryesore televizive dhe gazetave ditore janë grumbulluar për të vlerësuar shpenzimet e Reklamimit të Subjekteve Politike.

IV. Rezultatet dhe vëzhgimet e përgjithshme

Rezultatet detale të auditimit do të paraqiten përmes këtij raporti, po disa rezultate të veçanta meritojnë të jenë të theksuara.

a) Auditorët tan dhe po ashtu as Zyra për Regjistrimin e Partive Politike nuk ka gjetur asnjë dëshmi se Subjektet Politike që kanë marr pjesë në Zgjedhjet e Jashtëzakonshme per Kryetar te Komunës se

Rahovecut kanë kaluar Kufizimin e Shpenzimeve për fushatën. Secili Subjekti Politik që ka garuar për Kryetar të Komunës ka pasur kufizimin e shpenzimeve prej 26,180.00.

b) Disa nga Subjektet Politike ende nuk janë në pajtueshmëri të plotë me kërkesat për publikimin e Raporteve Financiare të fushatës. Audituesit konsiderojnë si shkelje më serioze të jetë deklarimi i raporteve jo të plota si dhe dështimi të publikojnë burimet e të hyrave.

c) Në shumicën e rasteve Kontributet në natyrë janë nënvlerësuar apo nuk janë raportuar.

d) Zyra për regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim ka bërë shkelje kur ka pranuar Deklaratat financiare të nënshkruara nga personat që nuk janë të autorizuar nga vete Subjekti Politik, si pasojë kemi Subjekt Politik i cili nuk i pranon ato deklarata financiare.

Për qëllime të këtij auditimi, Kontributet në Natyrë janë definuar si të mira apo shërbime të ndonjë vlere të ofruar pa kompensim. Pra, Kontributi në Natyrë bëhet p.sh : kur subjekti politik merr hapësirën për zyre pa pagesë; kur i mban tubimet pa paguar qira për ndërtesat ose shërbimet e këngëtarëve dhe të zbatimësve; ose kur pranon shërbime pune nga aktivistët në bazë vullnetare (përveç formës me punë vullnetare të pakualifikuar të ofruar nga individët privatë). Gjithashtu mendohet si Kontribut në Natyrë kur dikush jep automjetin falas, ose karburantet dhe shoferin. Kontributet në natyrë nuk duhet të kufizohen vetëm në shembujt e lartpërmendur.

Auditorët kanë gjetur shumë raste serioze kur shpenzimet janë raportuar më pak se sa ka qenë vlera reale e tyre. Pra, logjikisht shihet se edhe të Hyrat e deklaruara për financimin e shpenzimeve të fushatës janë raportuar më pak në vlerë ekuivalente.

Në disa e raste, fletë-Bilanci i Subjekteve Politike nuk është i plotësuar drejt, edhe aty ku është prezantuar nuk ka qenë i balancuar.

Në përgjithësi, shumica e Subjekteve kanë nënvlerësuar Shpenzimet e tyre në kategoritë si në vijim:

Qiraja e Zyrës, paga dhe shërbimet komunale

Vetëm disa Subjekte pohojnë që zotërojnë zyre të cilitdo lloj. Prandaj, zyrat e tjera duhet të merren me qira ose të sigurohen pa pagesë nga anëtarët ose përkrahësit e subjekteve politike. Të gjitha subjektet e mëdha kanë degë ose nëndegë në ne Komunën e Rahovecut. Jo të gjitha subjektet politike kanë deklaruar se kanë bërë shpenzime për zyrat e degëve apo të selive të tyre. Pagesat e bëra për vëzhguesit e zgjedhjeve nuk janë deklaruar apo të dokumentuara siç duhet nga disa subjekte politike.

Spotet televizive dhe të radios

Auditorët tan kanë tentuar të mbledhin informata nga stacionet e TV-së dhe mediat e shkruara lidhur me hapësirën e transmetimit dhe hapësirën reklamuese të shfrytëzuar nga Subjektet Politike në zgjedhjet e jashtëzakonshme në Komunën e Rahovecut, por kjo ka qenë e pamundur pasi ka pasur kufizime nga disa media elektronike dhe të shkruara të cilat nuk kanë bashkëpunuar me auditorin e fushatës.

Në shumicën e rasteve, informatat e mbledhura nuk përgjigjen me shifrat e prezantuara nga Subjektet. Është vërejtur se kandidatët e Subjekteve të ndryshme që garonin për Zgjedhje kanë prodhuar spotet në TV ose radio nga shpenzimet vetanake dhe nuk i kanë raportuar Subjektit të tyre Politik. Auditori i fushatës e

konsideron këtë shpenzim si pjesë e fushatë së Subjekteve pasi që kandidati gjithashtu ka garuar nën emrin e Subjektit.

Billbordat

Auditori i fushatës nuk ka arrit të mbledh informata krahasuese e as konfirmim nga palët e treta për këtë lloj të shpenzimeve të SP, mirëpo megjithatë duke pasur parasysh volumin e reklamimeve në billborda të bëra nga SP gjatë fushatës zgjedhor në mundë të përfundojmë që shpenzimet e deklaruara nga SP janë të nënvlerësuara.

Mitingjet Politike

Gjatë auditimit ton në kemi vërejtur që shumica e SP kanë nën dekluar shpenzimet për mitingjet politike.

Transporti

Vetëm disa Subjekte Politike kanë automjete. Pavarësisht nga mënyra se si janë marrë automjetet, shfrytëzimi paraqet element shpenzimi edhe nëse ato automjete janë dhënë pa kompensim, kjo paraqet një kontribut në natyrë të cilin është dashur të publikohet.

V. Gjetje e përgjithshme të këtij raporti

- Disa nga SP nuk udhëheqin kontabilitet të mirëfilltë për SP duke shkelur Nenin 21 të rregullorës 01/2008 dhe nenin 5 përkatësisht 6 të Ligjit Nr. 03/L-174 (Për Financimin e Partive Politike)
- Të gjitha SP bëjnë shkelje të Nenit 17 të Ligjit Nr. 03/L-174 (Për Financimin e Partive Politike) duke mos ushtruar kontroll të brendshëm financiar dhe duke mohuar të drejtën e anëtarëve për t'u informuar për të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e subjekteve politike.
- Auditori konsideron si dobësi në kontrollin e brendshëm pagesat dhe pranimin e parave në kesh tek shumica e SP, po ashtu verifikimi i shpenzimeve në kesh dhe verifikimi i donacioneve të marra në kesh ishte i pamundur pasi që shumica e SP nuk mbajnë një regjistër detaj të arkës duke regjistruar të gjitha hyrjet dhe daljet e parasë se gatshme.
- Po thuajse të gjitha SP nuk kanë personel profesional (zyrtar financiar) të certifikuar si kontabilist dhe kompetent për kontabilitet dhe raportim financiar
- Disa nga SP kanë bërë shkelje të Nenit 40 pika 40.6 të Ligjit Nr. 03/L-073 (Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë), ky nen obligon Secilin subjekt politik të certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhje të mban dhe ruan në arkivat e tyre, për një periudhë shtatë (7) vjeçare, shënimet e sakta dhe të detajuara të gjendjes financiare të subjektit dhe të gjitha degëve për periudhën e mbuluar me Raportet e Publikimit Financiar të Fushatës.
- Dokumentet mbështetëse për të hyrat dhe shpenzimet, si kopjet e faturave, raporti bankar etj, nuk janë dorëzuar në Zyrë nga disa SP, siç kërkohet me rregullorën 01/2008 Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, Nenit 20 Raportet financiare vjetore.
- KQZ në mungesë të stafit profesional ka bërë shkelje të nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-174 (Për Financimin e Partive Politike) pika 1;2 dhe 3 duke pranuar raportet e publikimeve financiare të fushatës të pa kompletuara.
- KQZ në mungesë të stafit profesional ka bërë shkelje të nenit 19 të Ligjit Nr. 03/L-174 (Për Financimin e Partive Politike) pika 1 dhe 2 duke mos kryer kontrollin e secilit raport financiar, dhe

këto raporte financiare te kontrollohen ne përputhje me Standardet e Kontabilitetit te zbatueshme ne Kosovë.

- KQZ nuk ka respektuar Rregulloren Zgjedhore Nr.12/2009-Kufizimi i shpenzimeve te fushatës dhe deklarimi financiar neni 3.5 kërkon
 - Të gjithë zyrtarët për financa ndjekin një trajnim për llogaritjen dhe auditimin, të organizuar nga Zyra menjëherë pas emërimit të tyre, përveç ne rastet kur ata i ofrojnë Zyrës një shkallë të pranueshme të ekspertizës dhe përvojës që tregon se një trajnim i tillë nuk është i domosdoshëm. Shumica e zyrtarëve financiar te SP nuk kanë mbajtur trajnime te tilla pasi qe ato nuk janë organizuar nga Zyra, prandaj edhe kompetenca profesionale tek Zyrtarët financiar te SP për përgatitjen dhe plotësimin e formularëve financiar mungonte.
Ne KQZ mungon një zyrtar financiar i përgatitur profesionalisht, përgjegjësi e të cilit/cilës është kontrollimi i deklaratave financiare të SP dhe organizimi i trajnimeve për zyrtaret financiar te SP.
- Disa SP-e nuk kanë raportuar dhe sjellë dëshmitë fotokopje me një specifikacion për shpenzimet mbi 100.00€
- Formularët e publikimit Financiar te fushates nuk jane adekuat per raportim te ndermjetem pasi qe kërkojne informata te cilat nuk munde te saktësohen ne mes te periudhes dhe po ashtu ngerthejn ne vetvete aktivite qe nuk i takojne fushatës, si pasoj e kësaj disa nga subjektet politike kanë deklaruar vetem pasqyren e Fitimit /Humbjes si aktivitet te fushatës pasi qe deklarimi i Bilancit te Gjendjes për nje periudhe te ndermjete ishte i pamundur.

VI. REKOMANDIMET

Është e qartë se shumë përmirësime janë te domosdoshme, në anën e Subjekteve Politike, rregullativës ligjore dhe rregulloreve te KQZ-ës por edhe Zyra për Regjistrimin e Partive Politike duhet te avansohet më shumë sa i përket Publikimeve Financiare te SP, në mënyrë që të sigurohet transparenca më e madhe e mundshme në publikimet financiare të partive politike.

Disa nga këto rekomandime janë të radhitura si vijon:

- U rekomandojmë partive politike të mbajnë kontabilitetit te mirëfilltë për mbajtjen e shënimeve të transaksioneve të tyre financiare brenda kornizës së parimeve të SKK-ve të aplikueshme ne Kosovë.
- Ne u rekomandojmë SP qe te regjistrojnë dhe ruajnë shënimet e tyre për te gjitha transaksionet e ndodhura.
- Ne ju rekomandojmë SP qe te kryejnë te gjitha pagesat dhe te pranojnë te gjitha donacionet përmes llogarisë bankare, përveç rasteve te shpenzimeve te vogla, po ashtu qe te mbajnë një regjistër detal te arkës duke regjistruar te gjitha hyrjet dhe daljet e parasë se gatshme.
- Po ashtu, që raportimet financiare te jen sa ma cilësore, është e rëndësishme që përfaqësuesit financiarë të partive politike të vazhdojnë trajnimin e tyre dhe të testohen rregullisht njohuritë e tyre lidhur me parimet e kontabilitetit.
- Partitë Politike duhet te ushtrojnë kontroll te brendshëm financiar, te lëshojë raporte te shkruara mbi këtë kontroll financiar, në formë te auditimit te brendshëm.



-
- Te gjitha SP duhet ta arkivojnë dhe ruajnë dokumentacioni financiar për se pakut 7 vite. Ndërsa pjesën e te ardhurave te personelit për 10 vite.
 - Zyra për regjistrim te PP te punësoj një zyrtar financiar profesionist , se pakut kontabilist i licencuar, ne mënyrë qe gjatë pranimit te raporteve financiare dhe behet një kontroll e dokumentacionit te pranuar, po ashtu që SP te jenë ma mirë te informuara mbi përmbajtjen e Raporteve Financiare. Ky zyrtar duhet ta ketë detyrë edhe politiken e trajnimit te zyrtarëve financiar te SP
 - Te ndryshohen formularët e publikimit financiar te fushatës dhe te adaptohen sipas specifikave qe ngërthen ne vehte ky aktivitet duke mundësuar nje ndarje te plote ne mes te aktiviteteve te rregullta vjetore dhe aty te zhvilluara gjatë fushatës zgjedhore.
 - Raportet e Deklarimit Financiar te pranohen vetem atëhere kur jane te nënshkruara nga personat e autorizuar te Subjektit Politik.

Audit & Conto

Ymer Shatri

Audit Partner


www.audit-conto.com

email: info@audit-conto.com

Tel: +381 38 248 971

Prishtinë 17 Dhjetor 2012

NDERMARRJA SHERBYESE
"AUDIT & CONTO"
sh.p.k.

Raportet e Publikimeve Financiare dhe të gjeturat e Auditorit

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
Raporti i publikimit financiar dhe të gjeturat e auditorit të pavarur
Zgjedhjet jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Rahovec
15/10/2010-21/11/2010
Raundi i dytë i zgjedhjeve 13/12/2010-19/12/2010

Raporti i publikimit financiar dhe te gjeturat e auditorit te pavarur

Emri i Partisë:	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
Akronimi:	AAK
Adresa:	Bulevardi I Dëshmorëve 49
Komuna:	Prishtinë
	15/10/2010-21/11/2010 dhe
Periudha e raportimit:	13/12/2010-19/12/2010

Fletë Bilansi dhe deklarat e fitimit / humbjes

Bilanci në fillim të periudhës	Shuma në Euro
Mjetet	
Aparatet dhe veglat	
pajisjet	
Prona e patundshme që posedohet	
Llogaritë që merren	
Xhirrollogarite bankare	
Paratë e gatshme	
Gjithsej mjetet	
Saldoja në fillim të periudhës	
Gjithsej detyrimet	
Gjithsej saldoja dhe detyrimet	
Gjithsej te hyrat	0.00
Shpenzimet	
Rrogat dhe kompenzimet, përfshirë beneficionet	0.00
Shpenzimet e transportit	0.00
Reprezentacioni dhe konferncat	0.00
Reklamimet	0.00
Shpenzimet e fushatës	0.00
Blerja e mallrave	0.00
Shpenzimet e ndryshme	0.00
Shpenzimet e përgjithshme	0.00
Gjithsej shpenzimet	0.00
Humbja (+) ose fitimi (-)	0.00
Bilansi ne fund të periudhës	
Mjetet	
Aparatet dhe veglat	

pajisjet

Prona e patundshme që posedohet

Llogaritë që merren

Xhirrollogarite bankare

Paratë e gatshme

Gjithsej mjetet

Saldoja në fillim të periudhës

Humbja (+) ose fitimi (-) gjatë periudhës

Saldoja në fundë te periudhës

Gjithsej detyrimet

Gjithsej saldoja dhe detyrimet

Te gjeturat:

Subjekti Politik nuk ka plotesuar formularin e publikimit financiar ashtu siq kerkohe me Ligjin 03/L-072 Për zgjedhjet Lokale ne Republiken e Kosovës, si pasoj ne nuk ishim ne gjendje te verifikonim nese te hyrat dhe shpenzimet e fushates jane ne pajtim me Ligjin e cekur me larte.

Po ashtu dokumentet mbështetese per te hyrat dhe shpenzimet, si kopjet e faturave, raporti bankar etj, nuk jane dorëzuar ne Zyrë ashtu siç kërkohet me Ligjin 03/L-072 Për zgjedhjet Lokale ne Republiken e Kosovës, si pasoj ne nuk ishim ne gjendje te verifikonim nese te hyrat dhe shpenzimet e raportuara jane ne perputhje me Ligjin e cekur me larte.

Raundi i dytë i zgjedhjeve 13/12/2010-19/12/2010

Te gjeturat:

Subjekti Politik nuk e ka dorezuar formularin e publikimit financiar per Raundin e dytë ne Zgjedhjet e Jashtëzakonshme per Kryetar Komune në Rahovec.

Lidhja Demokratike e Kosovës

Raporti i publikimit financiar dhe të gjeturat e auditorit të pavarur

Zgjedhjet jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Rahovec

15/10/2010-21/11/2010 dhe

Raundi i dytë i zgjedhjeve 13/12/2010-19/12/2010

Raporti i publikimit financiar dhe te gjeturat e auditorit te pavarur

Emri i Partisë: Lidhja Demokratike e Kosovës
Akronimi: LDK
Adresa: Kompleks Qafa Rr:UÇK-B2
Komuna: Prishtinë
 15/10/2010-21/11/2010 dhe
Periudha e raportimit: 13/12/2010-19/12/2010

Fitet e Bilansit dhe deklarata e fitimit / Humbjes

Bilanci në fillim të periudhës	Shuma në Euro	
Bilanci në fillim të periudhës		
Mjetet		
Aparatet dhe veglat	0.00	Shuma në Euro
Pajisjet	0.00	
Prona e patundshme që posedohet		
Mjetet		
Llogaritë që merren		
Xhirrollogarite bankare		
Paratë e gatshme		
Aparatet dhe veglat		
Gjithsej mjetet	0.00	0.00
Saldoja në fillim të periudhës		
Gjithsej detyrimet		
Pajisjet		
Gjithsej saldoja dhe detyrimet		0.00
Gjithsej te hyrat	8,085.72	
Shpenzimet		
Prona e patundshme që posedohet	0.00	
Reklamat dhe shpenzimet për shpërblime të beneficionet	0.00	
Shpenzimet e transportit	0.00	
Reprezentacioni dhe konferncat	978.00	
Reklamimet	6,322.72	
Llogaritë që merren	0.00	
Shpenzimet e fushatës	0.00	
Blerja e mallrave	0.00	
Shpenzimet e ndryshme	0.00	
Xhirrollogarite bankare	785.00	
Shpenzimet e përgjithshme	785.00	
Gjithsej shpenzimet	8,085.72	
Paratë e gatshme		
Humbja (+) ose fitimi (-)		
Bilansi ne fund të periudhës		
Mjetet		
Aparatet dhe veglat	0.00	
Gjithsej mjetet		

Pajisjet	0.00
Prona e patundshme që posedohet	
Llogaritë që merren	
Xhirrollogarite bankare	
Paratë e gatshme	0.00
Gjithsej mjetet	0.00
Saldoja në fillim të periudhës	
Humbja (+) ose fitimi (-) gjatë periudhës	0.00
Saldoja në fundë te periudhës	
Gjithsej detyrimet	
Gjithsej saldoja dhe detyrimet	

Shënimi 1: Te hyrat

	Në Euro
Të hyrat për periudhën e raportimit	
Tarifat e anëtarësisë	
Donacionet dhe kontributet në të holla	2,115.00
Vlera e gjithëmbarshme e kontributeve në natyrë në mall dhe shërbime	
Të hyrat tjera – Buxheti i Kosovës	5,970.72
Gjithsej të hyrat	8,085.72

Shënimi 2: Donacionet dhe kontributet në të holla

Pranuar nga				Vlera
Emri	Adresa	Numri personal	Data kur është dhënë kontributi	në euro
Nahit Elshani	Fsh.Brestovc	1016052082	25.10.2010	500.00
Nahit Elshani	Fsh.Brestovc	1016052082	01.11.2010	615.00
Avdullah Kryeziu	Rr.Xhevat&Alajdin Elshani	1003674688	25.10.2010	500.00
Avdullah Kryeziu	Rr.Xhevat&Alajdin Elshani	1003674688	01.11.2010	500.00
Total donacionet dhe kontributet në te holla				2,115.00

Raundi i dytë i zgjedhjeve 13/12/2010-19/12/2010

Raporti i publikimit financiar dhe te gjeturat e auditorit te pavarur

Emri i Partisë: Lidhja Demokratike e Kosoves
Akronimi: LDK
Adresa: Kompeksi Qafa Rr:UCK 2B
Komuna: Prishtine
Periudha e raportimit: 13.12.2010-19.12.2010

Fletë Bilansi dhe deklarat e fitimit / humbjes

Bilanci në fillim të periudhës	Shuma në Euro
Mjetet	
Aparatet dhe veglat pajisjet	
Prona e patundshme që posedohet	
Llogaritë që merren	
Xhirrollogarite bankare	
Paratë e gatshme	
Gjithsej mjetet	
Saldoja në fillim të periudhës	
Gjithsej detyrimet	
Gjithsej saldoja dhe detyrimet	
Gjithsej te hyrat	680.00
Shpenzimet	
Rrogat dhe kompenzimet, përfshirë beneficionet	0.00
Shpenzimet e transportit	93.00
Reprezentacioni dhe konferncat	186.50
Reklamimet	0.00
Shpenzimet e fushatës	0.00
Blerja e mallrave	245.50
Shpenzimet e ndryshme	0.00
Shpenzimet e përgjithshme	155.00
Gjithsej shpenzimet	680.00
Humbja (+) ose fitimi (-)	0.00
Bilansi ne fund të periudhës	

Mjetet

Aparatet dhe veglat

pajisjet

Prona e patundshme që posedohet

Llogaritë që merren

Xhirrollogarite bankare

Paratë e gatshme

Gjithsej mjetet

Saldoja në fillim të periudhës

Humbja (+) ose fitimi (-) gjatë periudhës

Saldoja në fundë te periudhës

Gjithsej detyrimet

Gjithsej saldoja dhe detyrimet

Shënimi 1: Te hyrat

Në Euro

Të hyrat për periudhen e raportimit

Tarifat e anëtarësisë

Donacionet dhe kontributet në të holla 680.00

Vlera e gjithmbarshme e kontributeve në natyrë në mall
dhe shërbime

Të hyrat tjera//Fondi nga BKK

Gjithsej të hyrat

680.00

Shënimi 2: Donacionet dhe kontributet në të holla

Pranuar nga				Vlera
Emri	Adresa	Numri personal	Data kur është dhënë kontributi	në euro
Enver Mazreku	F.SH.Apterushë	1002292366	16.12.2010	680.00
Total donacionet dhe kontributet në te holla				680.00

Partia Demokratike e Kosovës
Raporti i publikimit financiar dhe të gjeturat e auditorit të pavarur
Zgjedhjet jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Rahovec
15/10/2010-21/11/2010

Raporti i publikimit financiar dhe te gjeturat e auditorit te pavarur

Emri i Partisë: Partia Demokratike e Kosovës
Akronimi: PDK
Adresa: Rr:Nena Terezë N-20
Komuna: Prishtinë
Periudha e raportimit: 15/10/2010-21/11/2010

Fletë Bilansi dhe deklarat e fitimit / humbjes

Bilanci në fillim të periudhës	Shuma në Euro
Mjetet	
Aparatet dhe veglat	
pajisjet	
Prona e patundshme që posedohet	
Llogaritë që merren	
Xhirrollogarite bankare	
Paratë e gatshme	
Gjithsej mjetet	
Saldoja në fillim të periudhës	
Gjithsej detyrimet	
Gjithsej saldoja dhe detyrimet	
Gjithsej te hyrat	12,500.00
Shpenzimet	
Rrogat dhe kompenzimet, përfshirë beneficionet	0.00
Shpenzimet e transportit	1,910.97
Reprezentacioni dhe konferncat	1,306.00
Reklamimet	3,580.00
Shpenzimet e fushatës	0.00
Blerja e mallrave	0.00
Shpenzimet e ndryshme	5,700.00
Shpenzimet e përgjithshme	0.00
Gjithsej shpenzimet	12,496.97
Humbja (+) ose fitimi (-)	3.03

Bilansi ne fund të periudhës

Mjetet
Aparatet dhe veglat
pajisjet
Prona e patundshme që posedohet
Llogaritë që merren
Xhirrollogarite bankare

Paratë e gatshme	3.03
Gjithsej mjetet	3.03
Saldoja në fillim të periudhës	
Humbja (+) ose fitimi (-) gjatë periudhës	3.03
Saldoja në fundë te periudhës	3.03
Gjithsej detyrimet	
Gjithsej saldoja dhe detyrimet	3.03

Shënimi 1: Te hyrat

Në Euro

Të hyrat për periudhën e raportimit

Tarifat e anëtarësisë

Donacionet dhe kontributet në të holla 12,500.00

Vlera e gjithëmbarshme e kontributeve në natyrë në mall dhe shërbime

Të hyrat tjera

Gjithsej të hyrat

12,500.00

Shënimi 2: Donacionet dhe kontributet në të holla

Pranuar nga				Vlera
Emri	Adresa	Numri personal	Data kur është dhënë kontributi	në euro
Fadil Mullabazi	Rahovec	1016053330	05.11.2010	1,000.00
Shemsedin Spahiu	Apterushe	1005704216	07.11.2010	1,000.00
Qamil Sylka	Rahovec	1007984673	07.11.2010	1,000.00
Hamez Rama	Rahovec	1007864577	08.11.2010	1,000.00
Selajdin Haxhimurati	Rahovec	1002749579	08.11.2010	1,000.00
Xhemali Haxhimustafa	Rahovec	2002747327	08.11.2010	1,000.00
Hilmi Demiri	Rahovec	1007986820	09.11.2010	1,000.00
Xhelal Canziba	Rahovec	1030389669	09.11.2010	1,000.00
Feriz Vehapi	Zatriq	1002551884	10.11.2010	1,000.00
Tasim Berisha	Hoçe e Vogel	1030202607	10.11.2010	1,000.00
Rrahman Kabashi	Apterushe	1008183925	10.11.2010	500.00
Nexhat Daka	Rahovec	2002307467	10.11.2010	500.00
Vllaznim Isma	Rahovec	1002302108	11.11.2010	1,000.00
Ismajl Sylka	Rahovec	1001357723	11.11.2010	500.00
Total donacionet dhe kontributet në te holla				12,500.00

Te gjeturat:

Ne linjen “Shpenzimet e ndryshme” SP ka prezantuar pagesat per vezhguesit, nenshkrimet e vezhguesve qe kan pranuar mjete nuk jane te plota, po ashtu ne nuk ishim ne gjendje te verifikonim nese pagesat e bera per veshguesit ne emer te ketyre shpenzimeve jane tatimuar bazuar ne ligjet ne fuqi. Ky shpenzim te prezantohet ne pozicionin “ Rroga dhe kompenzime , perfshir edhe benificionet”

Aleanca Kosova e Re

Raporti i publikimit financiar dhe të gjeturat e auditorit të pavarur

Zgjedhjet jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Rahovec

15/10/2010-21/11/2010

Raporti i publikimit financiar dhe te gjeturat e auditorit te pavarur

Emri i Partisë: Aleanca Kosova e Re
Akronimi: AKR
Adresa: Rruga Uçk nr 55/R
Komuna: Prishtinë
Periudha e raportimit: 15/10/2010-21/11/2010

Fletë Bilansi dhe deklarat e fitimit / humbjes

Bilanci në fillim të periudhës	Shuma në Euro
Mjetet	
Aparatet dhe veglat	
pajisjet	
Prona e patundshme që posedohet	
Llogaritë që merren	
Xhirrollogarite bankare	
Paratë e gatshme	
Gjithsej mjetet	0.00
Saldoja në fillim të periudhës	
Gjithsej detyrimet	
Gjithsej saldoja dhe detyrimet	
Gjithsej te hyrat	17,500.00
Shpenzimet	
Rrogat dhe kompenzimet, përfshirë beneficionet	0.00
Shpenzimet e transportit	929.90
Reprezentacioni dhe konferncat	11,011.50
Reklamimet	8,664.00
Shpenzimet e fushatës	1,500.00
Blerja e mallrave	206.00
Shpenzimet e ndryshme	0.00
Shpenzimet e përgjithshme	1,145.00
Gjithsej shpenzimet	23,456.40
Humbja (+) ose fitimi (-)	(5,956.40)

Bilansi ne fund të periudhës

Mjetet
Aparatet dhe veglat
pajisjet
Prona e patundshme që posedohet

Llogaritë që merren	
Xhirrollogarite bankare	
Paratë e gatshme	217.60
Gjithsej mjetet	217.60
Saldoja në fillim të periudhës	
Humbja (+) ose fitimi (-) gjatë periudhës	(5,956.40)
Saldoja në fundë te periudhës	(5,956.40)
Gjithsej detyrimet	6,174.00
Gjithsej saldoja dhe detyrimet	217.60

Shënimi 1: Te hyrat

	Në Euro
Të hyrat për periudhën e raportimit	
Tarifat e anëtarësisë	
Donacionet dhe kontributet në të holla	14,000.00
Vlera e gjithëmbarshme e kontributeve në natyrë në mall dhe shërbime	3,500.00
Të hyrat tjera Kuvendi	
Gjithsej të hyrat	17,500.00

Shënimi 2: Donacionet dhe kontributet në të holla

Pranuar nga				Vlera
Emri	Adresa	Numri personal	Data kur është dhënë kontributi	në euro
Behgjet Pacolli	Rr:Fehmi Agani Prishtine	1173754201	30.10.2010	1,000.00
Behgjet Pacolli	Rr:Fehmi Agani Prishtine	1173754201	01.11.2010	1,000.00
Behgjet Pacolli	Rr:Fehmi Agani Prishtine	1173754201	02.11.2010	1,000.00
Behgjet Pacolli	Rr:Fehmi Agani Prishtine	1173754201	03.11.2010	1,000.00
Behgjet Pacolli	Rr:Fehmi Agani Prishtine	1173754201	04.11.2010	1,000.00
Behgjet Pacolli	Rr:Fehmi Agani Prishtine	1173754201	05.11.2010	1,000.00
Behgjet Pacolli	Rr:Fehmi Agani Prishtine	1173754201	08.11.2010	1,000.00
Behgjet Pacolli	Rr:Fehmi Agani Prishtine	1173754201	09.11.2010	1,000.00
Behgjet Pacolli	Rr:Fehmi Agani Prishtine	1173754201	10.11.2010	1,000.00
Behgjet Pacolli	Rr:Fehmi Agani Prishtine	1173754201	12.11.2010	1,000.00

Behgjet Pacolli	Rr:Fehmi Agani Prishtine	1173754201	13.11.2010	1,000.00
Behgjet Pacolli	Rr:Fehmi Agani Prishtine	1173754201	15.11.2010	1,000.00
Behgjet Pacolli	Rr:Fehmi Agani Prishtine	1173754201	16.11.2010	1,000.00
Behgjet Pacolli	Rr:Fehmi Agani Prishtine	1173754201	19.11.2010	1,000.00
Total donacionet dhe kontributet në te holla				14,000.00

Shënimi 3: Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime

Pershkrimi i mallit/shërbimeve te pranuar	Pranuar nga			Data kur është dhënë kontributi	Vlera në euro
	Emri	Adresa	Numri personal		
Spote Zgjedhore	IN IT	Rr:Nena Tereze Prishtine	600186987	14.11.2010	2,000.00
Material Propagandues	Studio Design	Gjakovë	70213845	19.11.2010	1,500.00
Total kontributet në natyrë në mall dhe shërbime					3,500.00

Lidhja Demokratike e Dardanisë
Raporti i publikimit financiar dhe të gjeturat e auditorit të pavarur
Zgjedhjet jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Rahovec
15/10/2010-21/11/2010

Raporti i publikimit financiar dhe te gjeturat e auditorit te pavarur

Emri i Partisë: Lidhja Demokratike e Dardanisë
Akronimi: LDD
Adresa: Isa Kastrati 117
Komuna: Prishtinë
Periudha e raportimit: 15/10/2010-21/11/2010

Fletë Bilansi dhe deklarata e fitimit / humbjes

Bilanci në fillim të periudhës **Shuma në Euro**

Mjetet

Aparatet dhe veglat

pajisjet

Prona e patundshme që posedohet

Llogaritë që merren

Xhirrollogarite bankare

Paratë e gatshme

Gjithsej mjetet

Saldoja në fillim të periudhës

Gjithsej detyrimet

Gjithsej saldoja dhe detyrimet

Gjithsej te hyrat **1,500.00**

Shpenzimet

Rrogat dhe kompenzimet, përfshirë beneficionet 0.00

Shpenzimet e transportit 0.00

Reprezentacioni dhe konferncat 0.00

Reklamimet 1,500.00

Shpenzimet e fushatës 0.00

Blerja e mallrave 0.00

Shpenzimet e ndryshme 0.00

Shpenzimet e përgjithshme 0.00

Gjithsej shpenzimet **1,500.00**

Humbja (+) ose fitimi (-) **0.00**

Bilansi ne fund të periudhës

Mjetet

Aparatet dhe veglat

pajisjet

Prona e patundshme që posedohet

Llogaritë që merren

Xhirrollogarite bankare

Paratë e gatshme

Gjithsej mjetet

Saldoja në fillim të periudhës

Humbja (+) ose fitimi (-) gjatë periudhës

Saldoja në fundë te periudhës

Gjithsej detyrimet

Gjithsej saldoja dhe detyrimet

Shënimi 1: Te hyrat

	Në Euro
Të hyrat për periudhën e raportimit	
Tarifat e anëtarësisë	
Donacionet dhe kontributet në të holla	1,500.00
Vlera e gjithëmbarshme e kontributeve në natyrë në mall dhe shërbime	
Të hyrat tjera	
Gjithsej të hyrat	1,500.00

Shënimi 2: Donacionet dhe Kontributet në të holla

Pranuar nga				Vlera
Emri	Adresa	Numri personal	Data kur është dhënë kontributi	në euro
Qerim Kadiri	Rahovec	1030202224	16.11.2010	350.00
Lulzim Kabashi	Prizren	1500859004	10.11.2010	600.00
Shefki Gashi	Prishtine	2004048667	09.11.2010	550.00
Total donacionet dhe kontributet në te holla				1,500.00

Të gjeturat:

Raporti bankar nuk eshte dorëzuar ne Zyrë ashtu siç kërkohet me Ligjin 03/L-072. Auditorit te fushates nuk i eshte ofruar qasje dhe informacion i duhur. Si pasoj ne nuk ishim ne gjendje te verifikonim nese te hyrat dhe shpenzimet e raportuara jane ne perputhje me Ligjin e cekur me larte